

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me zyrtarin ligjor Getoar Ademi, në çështjen penale kundër të akuzuarës F. H. nga fshati K. e M., komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.875/2016 të datës 23.01.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurori i Shtetit Ismet Tofaj, të akuzuarit, si dhe të përfaqësuesit të dëmtuarës L. M., me datë **15.10.2018**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

F. H., nga i ati Rr. dhe e ëma Sh., e gjinisë Sh., e lindur me datën ... në fshatin R., komuna e Gjakovës, ndërsa tani jeton në fshatin K. e M., komuna e Rahovecit, me nr. personal të identifikimit ..., punëtore, ka të kryer shkollën fillore, e martuar, e ëma e dy (2) fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Sepse:

Nga data e pavërtetuar e deri me datën 21.12.2015, në shtëpinë e saj, në fshatin K. e M., komuna e Rahovecit, në mënyrë të paautorizuar për shkak të borxhit të papaguar ka bërë rikycje në furnizim me energji elektrike, gjendje kjo e konstatuar me rastin e kryerjes së kontrollës nga personat e autorizuar të KEDS – Distrikti në Prizren.

Me këtë ka kryer veprën penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, të njëjtit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Gjykon me dënim me gjobë në shumën prej **dyqind (200) euro**, dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **nëntëdhjetë (90) ditëve**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afat prej **një (1) viti**, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara KEDS - Distrikti në Gjakovë, udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

Detyrohet e akuzuara që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP.nr.875/2016 të datës 23.01.2017, kundër të pandehurës F. H. nga fshati Kr. e M., komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datën 15.10.2018, ku ka qenë prezent përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Ismet Tofaj, e akuzuara, si dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës i autorizuari L. M..

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës, e akuzuara ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se ndihet fajtores dhe ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se e akuzuara e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtës i ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë dhe pasi e akuzuara e ka pranuar fajësinë, gjykata e ka njoftuar lidhje me efektet e pranimit të fajësisë. Po ashtu është kërkuar edhe mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës, i cili ka deklaruar se është i pajtimit me pranimin e fajësisë.

Andaj nga të lartëcekurat, pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 248 par.4 të KPRK-së, për shkak se e akuzuara në fillim të seancës fillestare është deklaruar e fajshme, në tërësi e ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata nuk ka proceduar administrimin e provave.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga e akuzuara, ka gjetur se e njëjta ka kryer veprën penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikur ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat për të cilat i përmban aktakuza e të cilat janë: Procesverbali nr.0909289 i dt.21.12.2015, procesverbali nr.1461713 i dt.09.12.2015, foto-dokumentacioni, si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e veprës penale me të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur të njëjtën ta shpall fajtores dhe ta gjykoj në bazë të ligjit.

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sips nenit 73 dhe 74 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të akuzuarës në gjykim, e njëjta është deklaruar e fajshme, si dhe i vjen keq për rastin që ka ndodhur, ndërsa rrethana veqanërisht rënduese nuk gjeti, andaj të njëjtës i'a ka shqiptuar dënimin me kusht me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesë pasurore – juridike të realizojë në procedurë të rregullt juridiko civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësorë bazohet në nenin 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC
- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal -
P.nr.44/2017, me datë 15.10.2018

Zyrtari Ligjor,
Getoar Ademi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.